



Funded by
the European Union

RËNDËSIA E PËRFSHIRJES SË PRINDËRVE NË JETËN SHKOLLORE TË FËMIJËVE TË TYRE

EDITORIAL



Funded by
the European Union

Diskutimi Publik

“Rëndësia e Përfshirjes së Prindërve në Jetën Shkollore të Fëmijëve të Tyre”

Prindërit janë palë e rëndësishme interesi në arsimimin e nxënësve/eve, dhe komunikimi i vazhdueshëm shkollë-shtëpi është mënyra më e mirë për të garantuar efikasitetin e kontributit të tyre. Zhvillimi psikologjik dhe akademik i fëmijëve realizohet falë bashkëpunimit të ngushtë e cilësor mes prindit dhe shkollës. Por, megjithëse ekziston korniza ligjore për funksionimin e Këshillave të Prindërve, duket se ambienti aktual nuk stimulon sa duhet përfshirjen e prindërve në jetën shkollore të fëmijëve të tyre.

Me qëllim të avokimit për këtë aspekt të rëndësishëm të jetës shkollore të fëmijëve, më 13 dhjetor 2021 në Hotel Sirius në Prishtinë u zhvillua një diskutim publik, i organizuar nga projekti **Cilësia, Llogaridhënia dhe Gjithëpërfshirja në Arsim 2021**. Ky projekt është i financuar nga Zyra e BE-së në Kosovë, dhe vihet në zbatim nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC). Iniciativa avokuese për përfshirjen efektive të prindërve në jetën shkollore të nxënësve është pjesë e Komponentës II të projektit të lartcekur, dhe synon identifikimin e mënyrave më frytdhënëse se si mund të fuqizohet marrëdhënia shkollë-shtëpi në dobi të fëmijëve.

Gjatë këtij takimi u shfaq një videospot i realizuar nga projekti për këtë qëllim, në të cilin shprehen pikëpamjet e palëve të ndryshme të interesit të cilat janë të përfshira në sistemin arsimor parauniversitar në Kosovë. Spoti në fjalë përfshinte nxënës/e, mësime/mësues/e dhe prindër nga komunitetet shumicë dhe jo-shumicë, ku secili/a prej tyre paraqiste nga një aspekt të caktuar të raportit shkollë-shtëpi dhe impaktit të tij tek fëmija.

Pjesëmarrësit e ftuar në takim ishin të tillë që përfshinin të gjitha palët që janë pjesë e sistemit arsimor parauniversitar, pra nxënës/e, mësime/mësues/e, drejtorë/eshë të shkollave, prindër, përfaqësues të këshillave të prindërve në nivel komunal e shkollore, si dhe përfaqësues të Divizionit për Bashkërendimin Prindër-Arsimtarë nga MASHTI. Pas shfaqjes së video-spotit, u hapën diskutimet rreth problematikës së gjerë të kësaj teme, ku rëndësi e veçantë iu dha zërit të nxënësve që ishin të pranishëm dhe përfaqësuesve të këshillave të prindërve. Nxënësit e pranishëm ishin të niveleve të ndryshme të arsimit fillor, të mesëm të ulët, dhe të mesëm të lartë. Ata/o shprehën aspektet e përfshirjes së prindit me të cilat janë të kënaqur, duke shtuar se ka aspekte ku mungon përfshirja aq sa duhet nga ana e familjes.

U theksua se shkolla duhet të krijojë atmosferë mikpritëse për prindërit, në mënyrë që këta të fundit të ndihen të mirëpritur kur shkojnë në shkollë për takim me mësuesit/et. Njëkohësisht, u

Zbatuar nga:





Funded by
the European Union

propozuan mënyra të stimulimit të prindërve për t'u përfshirë në aktivitetet e shkollës, meqenëse këshillat e prindërve varen nga angazhimi vullnetar i prindërve.

Në tërësi, diskutimi publik rreth rëndësisë së përfshirjes së prindërve në jetën shkollore të fëmijëve të tyre ishte shumë energjik dhe intensiv. Mendimet dhe propozimet e dhëna gjatë këtij takimi do të jenë pjesë e përpjekjeve avokuese për lehtësimin e kushteve drejt forcimit të marrëdhënies shkollë-shtëpi në dobi të fëmijëve.

Ky editorial është hartuar nga Bora Shpuza Kasapollari në kuadër të programit “Cilësia, Llogaridhënia dhe Gjithëpërfshirja në Arsim 2021” zbatuar nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) me mbështetjen e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë. Përmbajtja e këtij editoriali në asnjë mënyrë nuk mund të merret si reflektim i qëndrimeve të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë.

Zbatuar nga:

